



Periodiku AMF

Zhvillohet aktiviteti mbi Bursën Shqiptare të letrave me vlerë

Në përpjekje për aktivizimin e Bursës së Tiranës dhe krijimin e një sistemi tregtimi të letrave me vlerë (kryesisht aksioneve), në mënyrë të ngjashme me strukturat e tregtimit të shumë vendeve të Evropës, Ambasada Italiane, në bashkëpunim me bursën italiane, iniciuan projektin “Bursa shqiptare e letrave me vlerë”.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve për vitin 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për vitin 2010 arritën shifrën 8,206,840 mijë lekë, përkundrejt 7,878,259 mijë lekë të realizuara në vitin 2009 ose 4.17 % më shumë.

Vijon në faqen 2

Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2010

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2010 u dominua në masën 87.18% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 12.82% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

Vijon në faqen 5

Zhvillimet e tregut të pensioneve vullnetare private për vitin 2010

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, por ky si nga

këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për vitin 2010, shihet një rritje prej 53.38% e kontributeve dhe një rritje prej afër 12.71% e numrit të kontribuesve, krahasuar me një vit më parë.

Vijon në faqen 5

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Risiguruesit globalë mbeten të fortë pavarësisht sfidave

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), dhjetor 2010)

Tregu global i risigurimeve ka treguar se është i fortë përballë kushteve jo të favorshme, të vazhdueshme, në ekonominë reale dhe në tregjet financiare në përgjithësi.

Vijon në faqen 7

Edukimi i konsumatorit

Bazat e Risigurimit

(Material i përpunuar, i autorit Rodolfo Wehrhahn, nxjerrë nga Banka Botërore (BB), prill 2010)

Përkufizim

Risigurimi është një transaksion financiar me anë të të cilit transferohet (cedohet) risku nga një shoqëri sigurimi (ceduesi) tek një shoqëri risigurimi (risiguruesi) në shkëmbim të një pagese (prim risigurimi). Ofruesit e risigurimit janë risigurues profesionistë, ente që i përkushtohen ekskluzivisht aktivitetit të risigurimit, ndonëse në shumicën e juridiksioneve, shoqëritë e sigurimit lejohen që të marrin pjesë në risigurim.

Vijon në faqen 7

Në këtë numër:

Zhvillohet aktiviteti mbi Bursën Shqiptare të letrave me vlerë **2**

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura **2**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera **7**

Edukimi i konsumatorit **7**

Zhvillohet aktiviteti mbi Bursën Shqiptare të letrave me vlerë

Në përpjekje për aktivizimin e Bursës së Tiranës dhe krijimin e një sistemi tregtimi të letrave me vlerë (kryesisht aksioneve), në mënyrë të ngjashme me strukturat e tregtimit të shumë vendeve të Evropës, Ambasada Italiane, në bashkëpunim me bursën italiane, iniciuan projektin “Bursa shqiptare e letrave me vlerë”. Bashkia e Milanos, më 18 janar 2011, në Milano, zhvilloi aktivitetin Dita për Shqipërinë në të cilin u prezantua projekti “Bursa shqiptare e letrave me vlerë” ku morën pjesë përfaqësues të shumë bizneseve shqiptare dhe italiane.

Projekti mbi Bursën Shqiptare të letrave me vlerë u zhvillua në dy faza:

Faza e parë përfshin listimin e kompanive shqiptare në tregun AIM të Bursës së Italisë, dhe Faza e dytë nënkupton Aktivizimin e Bursës së Tiranës.

Gjatë seancës së zhvilluar në Milano, Prof. Ferranini në diskutimin “Mbi sistemet alternative të tregtimit” tregoi avantazhet që paraqet një treg alternativ kundrejt tregut të organizuar, veçanërisht për bizneset e vogla dhe të mesme. Në prezantimin e Zj. Lunghi, mbi Bursën e Italisë me fokus segmentin AIM, u përqëndrua në kërkesat dhe etapat që kërkohen të plotësohen për t'u listuar në segmentin AIM. Prezantimet e qarta dhe informative të mbajtura me kompetencë nga Prof. Ferranini dhe Zj. Lunghi, ndihmuan auditorin në krijimin e një koncepti të qartë mbi kërkesat dhe procedurat e listimit në tregun AIM të Bursës së Italisë.

Mbi tregun AIM të Bursës së Italisë:

- AIM Italia është segmenti i Bursës së Italisë që u dedikohet ndërmarrjeve italiane të vogla dhe të mesme me potencial rritjeje.
- AIM Italia u ofron mundësinë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të bëhen të njohura nga

investitorët ndërkombëtarë.

- AIM Italia është fleksibël, përsa u takon kërkesave të listimit.
- Këshilltarët apo brokerat vlerësojnë kompaninë me synimin drejt një listimi të suksesshëm.
- Investitorë institucionalë dhe individualë mund të aksesojnë tregun.

Detyrimet në AIM Italia

- Minimumi i tregtueshëm është 10% e kapitalit të kompanisë që listohet.
- Kompanitë duhet të japin informacion për investitorët, në mënyrë që ata të gjykojnë mbi vendimin e tyre. Për këtë arsye duhet të publikojnë:
 - o raporte vjetore dhe 6-mujore;
 - o transaksionet;
 - o transaksionet me palë të lidhura, si dhe;
 - o informacion mbi kompaninë në web-site.

Sipas projektit kërkohet që kompanitë shqiptare që do të listohen në AIM Italia të kenë një xhiro vjetore 20 milion deri 30 milion euro.

Bizneset shqiptare treguan interes me pjesëmarrjen e tyre në prezantimin e projektit e do të vijojnë më tej me konkretizimin e hapave që duhen ndërmarrë deri në finalizimin e listimit të tyre në Bursën e Italisë.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura


Vështrim mbi tregun e sigurimeve për vitin 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për vitin 2010 arritën shifrën 8,206,840 mijë lekë, përkundrajt 7,878,259 mijë lekë të realizuara në vitin 2009 ose 4.17% më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit

vullnetar zunë 48.10% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 51.90% të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 17.30% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje 3.11% të sigurimeve të Jo-Jetës. 88.98% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 10.34% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës dhe 0.67 % nga veprimtaria e risigurimit.

Gjatë vitit 2010 u nënshkruan rreth 736,278 kontrata sigurimi, ose rreth 2.57% më pak se vitin 2009.


Struktura e tregut të sigurimeve, viti 2010



Struktura e tregut të sigurimeve, viti 2010



Volumi i primit të shkruar bruto, viti 2010 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Volumi i primit të shkruar bruto, viti (2009-2010)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2009	2010
Viti	2009	2010
A) Sigurim i Jetës	723,648	848,804
B) Sigurim i Jo-Jetës	7,082,552	7,302,838
a) Sigurimi i Detyrueshëm	4,188,804	4,259,223
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	2,893,748	3,043,616
c) Risigurimi	72,059	55,197
TOTAL	7,878,259	8,206,840

Sigurimet e detyrueshme

Gjatë vitit 2010, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 51.90% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për vitin 2010, arritën 2,935,720 mijë lekë, ose 7.21% më shumë se në vitin 2009.

Në vitin 2010, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 910,209 mijë lekë, ose rreth 13.03% më pak se në vitin 2009.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë vitit 2010 arritën në 413,293 mijë lekë, apo 2.28% më shumë se në vitin 2009.

Sigurimet vullnetare

Në vitin 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 3,947,617 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), ose 7.00% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 3,098,813 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 34.15% të pasuara nga, sigurimi kasko me 19.28% dhe nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 15.95% peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet e garancisë si dhe prime nga veprimtaria e risigurimit.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në vitin 2010, arritën në 457,677 mijë lekë, 22.06% më shumë se në vitin 2009. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 80.06% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e Jetës në vitin 2010 arritën në rreth 848,804 mijë lekë, ose rreth 17.30% më shumë se në vitin 2009. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interbalkan, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 30.71% të primeve.

Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 52.19% të primeve.




Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në vitin 2010 kapi vlerën 2,292,090 mijë lekë, ose 32.60% më shumë se në vitin 2009. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,908,010 mijë lekë, apo 83.24% të totalit.

Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2010

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2010 u dominua në masën 87.18% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 12.82% nga instrumenta afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 98.73% e gjithë transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2010, flasin për një dominim të transaksioneve “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dhe “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” përkatësisht me 46.39% dhe 24.74% kundrejt volumit të përgjithshëm.



Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 96.66% të gjithë transaksioneve në këtë treg, në raport me personat juridikë.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë vitit 2010 ka pasur një zbritje prej 8,724.60 milionë lekë ose në masën 42.84%, krahasuar me vitin 2009, shoqëruar me një ulje në masën 10.80% të numrit të transaksioneve.

Transaksioni i llojit C “Blerje nga individët para

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë 2009, 2010

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale (në mijë lekë)		Ndryshimi (në %)
Viti		2009	2010	'10/'09-1
Letra me Vlerë të Qeverisë				
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	20,367.23	11,642.63	(42.84)
	Individë	8,196.13	7,278.34	(11.20)
	Persona juridike	12,171.10	4,364.29	(64.14)
C	Blerje nga individët para afatit të maturimit	2,950.54	4,192.42	42.09
	Individë	1,052.54	2,747.46	161.03
	Persona juridike	1,897.99	1,444.95	(23.87)

afatit të maturimit” gjatë vitit 2010 ka pasur një rritje prej 1,241.88 milionë lekë ose 42.09%, krahasuar me vitin 2009, ndjekur nga një rritje në masën 54.67% të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me vitin 2009, vihet re një zbritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth 7,482.73 milionë lekë.

Zhvillimet e tregut të pensioneve vullnetare private për vitin 2010

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një

treg i vogël, parë ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për vitin 2010, shihet një rritje prej 53.38% e kontributeve dhe një rritje prej afër 12.71% e numrit të kontribuesve, krahasuar me një vit më parë.

Më poshtë pasqyrohen disa të dhëna mbi tregun e pensioneve vullnetare private:

Tregu i Pensioneve Private Vullnetare (kontribute)

Shoqëria	Kontribute (në lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010		2009	2010
Viti			` 10/` 09-1		
Raiffeisen PENSIONS	39,420,560	50,434,238	27.94	54.02	45.06
Capital	19,522,151	45,065,548	130.84	26.75	40.27
Sigma IPP	14,025,862	16,420,362	17.07	19.22	14.67
Total	72,968,573	111,920,148	53.38	100.00	100.00

Tregu i Pensioneve Private (kontribues)

Shoqëria	Numri kontribuesve		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010		2009	2010
Viti			` 10/` 09-1		
Raiffeisen PENSIONS	1,679	1,786	6.37	37.91	35.78
Capital	1,774	2,191	23.51	40.05	43.89
Sigma IPP	976	1,015	4.00	22.04	20.33
Total	4,351	4,980	14.46	100.00	100.00



Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Risiguruesit globalë mbeten të fortë pavarësisht sfidave

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), dhjetor 2010)

Tregu global i risigurimeve ka treguar se është i fortë përballë kushteve jo të favorshme, të vazhdueshme, në ekonominë reale dhe në tregjet financiare në përgjithësi. Ky është konkluzioni kryesor i arritur nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) në Raportin e Tregut Global të Risigurimeve 2010.

Risiguruesit janë kontribuesit kryesorë për stabilitetin e tregjeve të sigurimeve, veçanërisht me anë të mbulimit që ata garantojnë kundrejt humbjeve nga katastrofat e natyrës dhe të shkaktuara nga njerëzit. Raporti i Tregut Global të Risigurimeve 2010, në Botimin e 7-të të tij, bazohet tek të dhënat unike, të dhëna nga 45 risiguruesit globalë në të gjithë botën, i cili në bashkëpunim me IAIS kontribuon për rritjen e njohurive për risigurimet, për të kuptuar, rregulluar e mbikëqyrur më mirë këtë industri kyçe financiare.

Risiguruesit rezultuan me rezultate financiare pozitive në vitin 2009, duke përfituar edhe nga menaxhimi i shëndoshë i portofoleve të aseteve dhe nga diversifikimi i risqeve të sigurimit, si dhe nga një vit i moderuar nga ana e katastrofave. Duke mos krijuar shqetësime sistemike në tregjet financiare, risiguruesit kanë kontribuar pozitivisht në stabilitetin financiar. Në veçanti, sektori i risigurimit ka vazhduar të fokusohet tek pranimi i riskut të diversifikuar, bazuar në të dhënat themelore të biznesit të risigurimit, për t'i rezistuar një kohe veçanërisht të trazuar për ekonominë në tërësi dhe sektorin financiar në veçanti.

Kryetari i Nëngrupit të Transparencës së Risigurimit, Jeremy Cox, gjithashtu thekson se: “pavarësisht kushteve jo të favorshme të

vazhdueshme, risiguruesit kanë demonstruar se janë në gjendje t'i kuptojnë dhe menaxhojnë risqet siç duhet; ky nuk është thjesht një lajm i mirë për sektorin e risigurimit, por mbi të gjitha, ky është lajm i mirë për policëmbajtësit”.

Është theksuar gjithashtu, se në një periudhë të reformës së shpejtë që prek rregullimin e tregjeve financiare, sektori i risigurimeve ka dhënë shembuj inkurajues të praktikave të shëndosha menaxhuese të riskut, të zbatuara në nivel global. Ka shumë për të mësuar nga kjo përvojë, dhe kjo është arsyeja përse IAIS është shumë e angazhuar për të vazhduar me mbikëqyrjen gjithëpërfshirëse të risigurimit dhe lidhjet e tij përtej kufijve dhe përtej sektorëve financiarë.

Edukimi i konsumatorit

Bazat e Risigurimit

(Material i përpunuar, i autorit Rodolfo Wehrhahn, nxjerrë nga Banka Botërore (BB), prill 2010)

Përkufizim

Risigurimi është një transaksion financiar me anë të të cilit transferohet (cedohet) risku nga një shoqëri sigurimi (ceduesi) tek një shoqëri risigurimi (risiguruesi) në shkëmbim të një pagese (prim risigurimi). Ofruesit e risigurimit janë risigurues profesionistë, ente që i përkushtohen ekskluzivisht aktivitetit të risigurimit, ndonëse në shumicën e juridiksioneve, shoqëritë e sigurimit lejohen që të marrin pjesë në risigurim. Termat e një transaksioni risigurimi përkufizohen në një traktat (treaty) risigurimi. Për shkak të kompleksitetit të traktateve të risigurimit, nuk është e pazakontë që traktatet definitive të nënshkruhen vetëm disa muaj pasi të jetë kryer transferimi i riskut. Për të dokumentuar pranimitin e riskut, në vend të traktatit përdoret një version i shkurtër i tij, dëftesa, që përmban termat më të rëndësishme të marrëveshjes. Dëftesat nënshkruhen përpara transferimit dhe pranimit të riskut nga risiguruesi. Disa juridiksione

kërkojnë që edhe traktatet të nënshkruhen përpara se të transferohet risku.

Risigurimi dallon nga bashkësigurimi, kur risku ndahet (dhe nuk transferohet) midis disa shoqërive të sigurimit, ku secila prej tyre ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë kontraktuale me të siguruarin për pjesën e riskut të pranuar nga vetë ajo. Kështu, risigurimi gjithmonë përfshin entet ligjore dhe jo individët. Në risigurim, marrëdhënia kontraktuale lidhet midis ceduesit dhe risiguresit. Vetëm në situata të veçanta traktati i risigurimit ka një dispozitë të quajtur klauzola prerëse (ose e përgjegjësive direkte) që i lejon të siguruarit të ketë një pretendim ligjor të drejtpërdrejtë ndaj risiguresit, për shembull, në rast se siguruari humbet aftësinë paguese. Edhe risiguresit mund t'i transferojnë risqet në ente të tjera të quajtura retrocesionarë me anë të një transaksioni financiar të ngjashëm me risigurimin të quajtur retrocesion.

Retrocesionarët profesionistë pritet që ta mbajnë dhe të mos e transferojnë tek entet e tjera riskun e marrë përsipër. Në këtë mënyrë, risiguresit dhe siguresit që i pranojnë risqet e paidentifikuar individualisht, mund të jenë të sigurt që nuk do të marrin përsipër asnjëherë atë pjesë të riskut që e kanë transferuar më parë. Megjithatë ka pasur situata në të kaluarën në të cilat retrocesionarët kanë transferuar më tej risqet e marra përsipër, duke çuar në mbajtje të tepërt të papritur për retroceduesit. Situata të tilla mund të shmangen me anë të formulimit të kujdesshëm të traktatit të retrocesionit.

Nevojat e risigurimit

Ka disa arsye që shtyjnë një shoqëri sigurimesh të përdorë risigurimin. Këtu do të diskutojmë ato më të rëndësishmet.

Rritja e kapacitetit të marrjes në sigurim

Shoqërive të sigurimeve shpesh u ofrohen risqe që mund ta tejkalojnë fuqinë e tyre financiare. Pjesa ceduese e riskut mund t'u lejojë atyre që ta

pranojnë riskun e plotë duke plotësuar kështu nevojat e klientit. Për këtë qëllim, shoqëritë e sigurimeve mund të përdorin edhe bashkësigurimin. Megjithatë, në këtë rast, shoqërisë së sigurimeve do t'i duhet të kontaktojë konkurruesit për të ndarë me ta një pjesë të riskut, çka dhe mund të mos jetë në interesin e saj më të mirë, veçanërisht në një treg konkurrues. Një dizavantazh tjetër i përdorimit të bashkësigurimit është barra që merr i siguruari që do t'i duhet të merret me secilën kompani siguruese pjesëmarrëse në lidhje me pagesat e primit dhe shlyerjet e pretendimit.

Përmirësimi i kapitalit të riskut dhe diversifikimi

Shoqëritë e sigurimeve që kanë një portofol më të diversifikuar të risqeve do të priren për të pasur rezultate financiare më të qëndrueshme. Përdorimi i risigurimit do tu lejojë shoqërive të sigurimeve që të marrin pjesë në një diversitet risqesh duke përdorur të njëjtin kapital punues, duke ceduar një pjesë të riskut dhe duke mbajtur një pjesë të vogël të secilit risk. Ky reduktim i përqendrimit tek risku do të zvogëlojë paqëndrueshmërinë e rezultateve vjetore. Efekti i diversifikimit ul kapitalin total të nevojshëm të riskut.

Lirimi i tepricës (Surplus relief)

Përdorimi i risigurimit u lejon shoqërive të sigurimeve të transferojmë pjesërisht risqet e tyre duke i hequr nga bilanci. Megjithëse përgjegjësia përfundimtare ndaj policëmbajtësve ende mbetet tek shoqëria e sigurimeve, shumica e juridiksioneve e njohin risigurimin si një mjet të menaxhimit të riskut që lejon një reduktim të kërkesave të tepricës ligjore. Garancia e dhënë në një kontratë risigurimi për të paguar pretendimet e të siguruarit njihet në kërkesat e kapitalit për ceduesin. Prandaj nuk është e pazakontë që kërkesat e matura të bazohen tek rrjeti i primit të siguruar të risigurimit. Kështu risigurimi largon një risk teknik, por ai sjell një risk kundërpattie, meqenëse, siç u



përmend më sipër, përgjegjësia përfundimtare ndaj mbajtësve të policave ende mbetet tek shoqëria siguruese. Për të kompensuar riskun e kundërpartisë, zakonisht kërkohet një tepricë shtesë. Ky kapital shtesë do të variojë sipas klasifikimit të aftësisë pagueuse të risiguruesit. Edhe shuma e lirit të tepricës së dhënë do të varet nga ky klasifikim.

Mbrojtja ndaj katastrofave

Shoqëritë e sigurimeve të drejtuara mirë e pranojnë ekspozimin ndaj riskut sipas fuqisë së tyre financiare. Megjithatë, siguruesi mund të ekspozohet edhe ndaj ngjarjeve të skajshme e jo të shpeshta si tërmetet, përmbytjet, rrëzimet e avionëve dhe ngjarje të tjera madhore katastrofike. Mbrojtja e kapitalit të mjaftueshëm për këto ngjarje të skajshme do ta bënte ushtrimin e sigurimeve të pasuksesshëm nga ana ekonomike ose të paktën shumë të kushtueshëm. Transferimi i këtij ekspozimi ndaj ngjarjeve katastrofike tek risiguruesit është një mënyrë më efektive për të trajtuar ngjarje tepër të rralla. Risiguruesit ofrojnë mbrojtje ndaj katastrofave në një mënyrë ekonomike më praktike se sa shoqëritë e sigurimeve duke marrë pjesë në ekspozimet katastrofike në të gjithë botën dhe duke e diversifikuar në këtë mënyrë më mirë riskun nga ana gjeografike. Zakonisht risiguruesit janë edhe më të kapitalizuar se sa shoqëritë siguruese. Ata operojnë edhe departamente të dedikuara që kanë fituar njohuri të shumta për karakteristikat fizike dhe historinë e ngjarjeve katastrofike duke u lejuar në këtë mënyrë të përcaktojnë çmimin dhe marrjen në risigurim më të përshtatshme.

Transferimi i ekspertizës

Nëpërmjet aktivitetit të risigurimit, risiguruesit që veprojnë në disa tregje me shoqëri të ndryshme sigurimesh kanë aftësinë që të fitojnë njohuri të mëdha për produktet e ndryshme, tregjet dhe teknikat e sigurimit si ato të marrjes në sigurim, administrimit të policave dhe

vlerësimit të pretendimeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur hyn në një treg të ri, në një linjë të re biznesi apo thjesht kur del për herë të parë një produkt i ri.

Transferimi i riskut nëpërmjet risigurimit mund të përfshijë edhe ndryshimin e marrjes në sigurim, të administrimit, apo aktiviteteve të tjera që lidhen me riskun që i transferohet risiguruesit. Marrëveshja e risigurimit u lejon siguruesve që të fokusohen në biznesin e tyre themelor duke ua kaluar ekspertëve të jashtëm aktivitetet jo thelbësore.

Financimi i biznesit të ri

Një aktivitet sigurimesh që rritet me shpejtësi mund të kërkojë financim paradhënie. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastin e biznesit të Sigurimit të Jetës. Këtu, shoqëria e sigurimeve duhet të financojë agjentët ose komisionet e ndërmjetësve, që të mund të jenë po aq të larta sa gjithë primi i plotë i vitit të parë, si dhe kostot e marrjes në sigurim që mund të përfshijnë kontrollet mjekësore dhe vlerësimet financiare. Pjesa risiguruese e biznesit mund të krijojë një burim financimi veçanërisht në qoftë se risiguruesi bie dakord të parapaguajë fitimet e pritura të ardhshme të biznesit në formën e komisionit risigurues. Ky burim financimi i biznesit të sigurimit mund të jetë tërheqës krahasuar me burime të tjera të tilla si kreditë bankare apo emetimi i aksioneve. Duke e njohur biznesin, risiguruesit do të ofrojnë pagesa risku më të ulëta se sa burimet financuese jo siguruese. Gjithashtu, në shumicën e marrëveshjeve të risigurimit, rimbursimi varet nga performanca e biznesit të risiguruar. Domethënë, parapagimi i fitimeve të ardhshme rikuperohet nga risiguruesi vetëm në qoftë se biznesi faktikisht i gjeneron këto fitime të pritura. Në qoftë se rimbursimi i financimit të risigurimit varet totalisht nga performanca e biznesit të risiguruar, në shumicën e juridiksioneve nuk ka nevojë të paraqitet asnjë detyrim në bilancin e ceduesit.

Nevojat e tjera të risigurimit dhe një fjalë paralajmëruese

Shoqëritë e sigurimeve hyjnë në marrëveshje risigurimi për një ose disa nga arsyet e lartpërmendura. Mund të ketë situata të tjera të veçanta në të cilat risigurimi përdoret si mjet financiar dhe operues i vlefshëm, megjithatë, në goftë se nuk është e pranishme asnjë nga nevojat e lartpërmendura, kërkohet një shqyrtim i veçantë i transaksionit. Me fleksibilitetin e madh të traktateve të risigurimit, që lejon zgjidhje efektive të përshtatura për të plotësuar nevojat individuale të shoqërisë së sigurimeve, është abuzuar në të kaluarën për të shmangur tatimet, për pastrim parash dhe veprimtari të tjera të paligjshme. Një marrëveshje risigurimi që nuk transferon asnjë lloj risku është gjithmonë e diskutueshme.

Llojet e marrëveshjeve të risigurimit

Shumica e kontratave të risigurimit janë ose traktate automatike (treaty), ose fakultative. Në rastin e traktatit risigures, të gjithë risqet që janë paracaktuar si objekt i marrëveshjes i cedohen automatikisht risiguresit, dhe risiguresi bie dakord t'i pranojë të gjitha këto risqe. Në një traktat fakultativ, ceduesi vendos nëse do t'i ofrohet risiguresit një risk i caktuar, dhe risiguresi do vendos individualisht nëse do ta pranojë apo jo riskun e ofruar. Ekziston një strukturë e tretë traktati më pak e zakonshme e quajtur risigurimi fakultativ – i detyrueshëm. Këtu, ofrimi i risqeve risiguresit bëhet në mënyrë fakultative, por pranimi i risqeve është i detyrueshëm për risiguresin.

Traktati i risigurimit (treaty)

Traktati i risigurimit i lejon ceduesit të veprojë në mënyrë reaguese të pavarur dhe të shpejtë kur pranon risqet që përfshihen në objektin e marrëveshjes së risigurimit. Në traktatin e risigurimit, pranimi i riskut nga risiguresi së bashku me të gjithë kushtet financiare është

negociuar paraprakisht. Karakteristika e traktatit të risigurimit, “pranimi i verbër” i risqeve të ofruara nga ceduesi, kërkon që risiguresi ta njohë dhe të ketë besim tek ceduesi. Traktati i risigurimit për këtë arsye ofrohet vetëm pasi risiguresi të ketë bërë verifikimet e duhura paraprake për shoqërinë e sigurimeve, për të përcaktuar cilësinë e biznesit që pritet të risigurojë. Aspektet e rëndësishme të cilave do t'i kushtojë vëmendje risiguresi përfshijnë: ekspertizën e shoqërisë, qëndrimin e saj ndaj riskut, të dhënat e mbajtura, shumën e pritur të biznesit që do të risigurohet dhe aspekte të tjera teknike. Më tej, risiguresi do të auditojë rregullisht ceduesin për tu siguruar se zbatohen termat e traktatit: respektohen udhëzimet e marrjes në sigurim, llojet e riskut të pranuar janë në përputhje me objektin e traktatit, të gjitha risqet që duhet të cedoheshin janë ceduar, është mbajtur kontabiliteti dhe administrimi i duhur, etj.

Risigurimi fakultativ

Shoqërive të sigurimeve u ofrohet herë pas here mundësia për të siguruar risqet komplekse, shumë të mëdha ose thjesht të pa zakonshëm. Në këto situata, alternativa më e mirë është risigurimi fakultativ. Këtu risiguresi merr pjesë në marrjen në sigurim dhe vlerësimin e riskut. Në varësi të riskut, risiguresi mund ta pranojë ose jo risigurimin. Në rast pranimi, risiguresi do të garantojë termat e veçantë, si primin, përjashtime e kështu me radhë. Traktati fakultativ tashmë i negociuar rregullon të gjitha termat e tjera të përgjithshme të marrëveshjes.

Format e risigurimit

Kryesisht ka dy forma të risigurimit: risigurimi proporcional dhe risigurimi jo-proporcional. Siç e tregojnë edhe emrat, në këto forma ka ose nuk ka ndarje përpjesëtimore të primit, pretendimeve, shpenzimeve, e kështu me radhë. Risigurimi proporcional krijon një lloj partneriteti midis ceduesit dhe risiguresit, meqenëse ata kanë një

përputhje të fortë të interesave në kryerjen e biznesit kryesor. Në risigurimin jo-proporcional, interesat zakonisht nuk përputhen dhe mundet edhe t'i kundërvihen performancës së biznesit.

*Risigurimi proporcional me përqindje kuotash
(Proportional quota share reinsurance)*

Sipas një traktati risigurimi me përqindje kuotash, ceduesi i transferon risiguresit të njëjtin përpjesëtim ose kuotë të secilit risk që përfshihet në objektin e marrëveshjes së risigurimit. Primi, shpenzimet dhe pretendimet ndahen po ashtu në të njëjtin përpjesëtim me risiguresin. Risiguresi i paguan ceduesit një komision risigurimi për ta kompensuar atë për shpenzimet e blerjes dhe ato administrative të biznesit. Gjithashtu është mjaft tipike që të përfshihet një formulë për ndarjen e fitimit, e cila pranon ndarjen e fitimeve të biznesit të risiguruar me ceduesin. Kjo bëhet për të shpërblyer ceduesin për cilësinë e marrjes në sigurim dhe përzgjedhjes së biznesit të pranuar nga ana e tij. Përpjesëtueshmëria e marrëveshjes aplikohet edhe për ndonjë lloj rezerve që mund të kërkojë biznesi. I risiguruari përgjigjet për ruajtjen e rezervave të duhura për pjesën e tij në biznes. Disa juridiksione kërkojnë që disa rezerva duhet të mbahen nga ceduesi ose një kujdestar. Në këto raste, risiguresi do t'ia dërgojë ceduesit ose kujdestarisë asetet e nevojshme për të ndërtuar rezervën që i korrespondon biznesit të risiguruar. Termat e treguara më sipër zakonisht dokumentohen për herë të parë në një dëftesë risigurimi kur bëhet një ofertë risigurimi. Dëftesa pastaj do të përdoret për të hartuar traktatin përfundimtar.

*Risigurimi me tepricë ose tejkalues (Surplus or
excedent reinsurance)*

Ky lloj sigurimi përpjesëtimor është kryesisht një marrëveshje me ndarje kuotash që transferon një përpjesëtim të ndryshëm të çdo risku. Për të përcaktuar përpjesëtimin e riskut që do të risigurohet, shoqëria e sigurimeve fikson një

shumë e quajtur vija e mbajtjes ose e tepricës si shuma maksimale e siguruar që shoqëria do të mbajë në llogarinë e saj. Çdo shumë mbi mbajtjen dhe deri në një shumë të dhënë e quajtur kapaciteti i kontratës do të risigurohet. Ndonjëherë kapaciteti jepet me numrin (shumëfishin) e vijave të tepricës. Risigurimi i tepricës i lejon ceduesit që të ndryshojë nivelin e pjesëmarrjes në çdo lloj risku duke zgjedhur një vijë të dhënë teprice për atë lloj risku specifik. Si ilustrim, le të konsiderojmë një traktat ku mbajtja është US\$50 dhe kapaciteti është US\$200 ose katër linja teprice:

- Një risk i veçantë që ka një shumë të siguruar prej 100US\$ do të ndahet midis siguresit dhe risiguresit në një përpjesëtim US\$50%.
- Për një risk që ka një shumë të siguruar prej US\$250, përpjesëtimi do të jetë 20% për siguresin dhe 80% për risiguresin.
- Një risk që ka një shumë të siguruar më të ulët se mbajtja nuk do të risigurohet fare.
- Po kështu, risqet me një shumë më të lartë të siguruar se sa kapaciteti nuk do të jenë pjesë e marrëveshjes së risigurimit.
- Megjithatë, vini re se gjenden e praktikave të ndryshme dhe në disa tregje, risiguresit do të pranojnë risqet me shumë të siguruar më të lartë se kapaciteti që do të risigurohet, e deri tek kapaciteti i traktatit me tepricë.

Elementët e financimit

Risigurimi proporcional krijon një përputhje të fortë të interesit midis siguresit dhe risiguresit meqenëse primi, shpenzimet dhe pretendimet ndahen në mënyrë proporcionale. Volumi i primit të risigurimit është i lartë krahasuar me risigurimin jo-proporcional për shkak të ndarjes së shpenzimeve. Një prim me volum të lartë mund t'i lejojë risiguresit që të financojë kosto substanciale paradhënie në shkëmbim të përfitimeve të ardhshme të biznesit të risiguruar.

Përcaktimi i çmimit

Përcaktimi i çmimit i primit të risigurimit në risigurimin proporcional kryesisht diktohet nga primi kryesor i sigurimit, sepse zakonisht vendoset si një përqindje e atij primi. Edhe shuma e komisionit të risigurimit duhet të pasqyrojë drejtpërdrejt kostot faktike që pëson ceduesi në blerjen dhe administrimin e biznesit. Nevojiten llogaritje më të detajuara kur përcaktohet formula e ndarjes së fitimit. Këtu përdoren modele të sofistikuar stokastike (probabilitare). Përfundimisht, kur marrëveshja e risigurimit përfshin disa lloje financimi, për shembull në formën e parapagimit për fitime të ardhshme kur vendoset çmimi i pagesës së risigurimit duhet të merren parasysh kostoja e kapitalit si dhe risku i kreditit dhe risku që biznesit të mos ketë ecurinë që pritej.

Risigurimi jo-proporcional

Shoqëritë e sigurimeve që kujdesen kryesisht për të mbrojtur portofolin e tyre nga përvojat negative që mund të çonin në shumë pretendime ose në shumë pretendime të larta, zakonisht hyjnë në marrëveshje proporcionale risigurimi. Në risigurimin jo-proporcional, mbrojtja garantohe duke u bazuar në humbjen faktike që pëson siguresi dhe jo në shumën e siguruar të riskut.

Risigurimi proporcional me tepriçë siç përshkruhet më sipër kërkon që shuma e siguruar e çdo risku individual të njihet për të përcaktuar përpjesëtuueshmërinë në ndarjen e riskut. Megjithatë ka disa produkte sigurimi ku shuma e siguruar nuk njihet gjithmonë, si MTPL-ja në Mbretërinë e Bashkuar ose përgjegjësia komerciale në SHBA, etj. Në këto raste kur dëshirohet mbrojtja individuale e diferencuar e riskut, mund të përdoret risigurimi proporcional.

Risigurimi i tejkalimit të humbjes (Excess of loss reinsurance)

Lloji bazë i risigurimit jo-proporcional është risigurimi i tejkalimit të humbjes (Excess of Loss, XL). Në një tejkalim të marrëveshjes së humbjes për risk, ceduesi do të paguajë në rastin e një ngjarjeje që ndikon mbi riskun e risiguar, shumën e pretenduar deri në një sasi fikse të zgjedhur të quajtur mbajtja e marrëveshjes. Risiguresi pastaj do të paguajë çdo tejkalim të shumës së pretenduar mbi mbajtjen deri në kapacitetin e kontratës.

Si shembull, konsideroni një tejkalim të humbjes ku mbajtja është 20\$US dhe kapaciteti është 100\$US (US\$100 XL US\$20):

- Një pretendim prej US\$50 do t'i kushtojë US\$20 ceduesit dhe US\$30 risiguresit (risku 1).
- Një pretendim prej US\$15 do të paguhet totalisht nga ceduesi, meqenëse shuma totale është nën përparësinë (risku 2).
- Një pretendim prej US\$130 do të kushtojë US\$20 + US\$10 = US\$30 ceduesit dhe US\$100 risiguresit. Këtu kapaciteti i plotë i traktatit është shteruar duke lënë një shumë prej US\$10 shtesë të pa mbuluar për ceduesin (risku 3).

Vini re veçorinë e rëndësishme të risigurimit me tepriçë: ai mbulon vetëm humbjet faktike mbi mbajtje, në mënyrë që pretendimet e vogla të riskut të risiguar të jenë të mbrojtura.

Primi i risigurimit për tejkalim të humbjes nuk është përpjestimor me primin e drejtpërdrejtë të arkëtuar nga siguresi dhe përcaktohet nga probabiliteti i ndodhjes së pretendimeve mbi mbajtjen dhe koston përkatëse të kapitalit. Gjithashtu, siç u përmend më parë, mund të shfaqet një konflikt interesash midis ceduesit dhe risiguresit: nxitja financiare e ceduesit për shlyerjen e pretendimit zhduket në momentin kur shuma e pretenduar është më e lartë se sa mbajtja, meqenëse përtej saj detyrimi i transferohet plotësisht risiguresit deri në kapacitetin e traktatit. Për të shmangur këto situata, disa marrëveshje kërkojnë ose që risiguresi të miratojë pagesat mbi mbajtje ose që ceduesi të pranojë një bashkëpagesë të

detyrimin mbi përparësinë.

Risigurimi i ndalimit të humbjes (Stop loss reinsurance)

Një marrëveshje për tejkalimin e humbjes që zbatohet për të gjithë portofolin quhet mbulim i ndalimit të humbjes. Risiguruesi do ta mbrojë ceduesin vetëm në rastin kur mbajtja tejkalohe, duke përfshirë gjithë pretendimet e paguara gjatë periudhës së mbulimit, zakonisht gjatë një viti. Në një mbulim tipik të ndalimit të humbjes, mbajtja shprehet si përqindje e primit të sigurimit dhe në shumicën e rasteve kërkohet një bashkëpagesë për tejkalimin e mbajtjes.

Për të kuptuar më mirë mënyrën se si funksionon një mbulim i ndalimit të humbjes konsideroni një marrëveshje të ndalimit të humbjes që ka si mbajtje 80% të primit të sigurimit, 20% të primit të sigurimit si kapacitet dhe një bashkëpagesë prej 25% mbi mbajtjen.

- Në qoftë se shuma totale vjetore e paguar në dëme është 70% e primit të sigurimit, ajo nuk e tejkalon përparësinë prej 80%. Këtu risiguruesi nuk do të marrë pjesë në pagesën e pretendimeve.
- Në qoftë se shuma totale e paguar në dëme është 100% e primit të sigurimit, risiguruesi paguan një shumë të barabartë me 16% të primit të sigurimit. Ceduesi paguan përparësinë e plotë të 80% dhe një bashkëpagesë prej 4% të primit të sigurimit.
- Në qoftë se shuma totale e paguar në dëme është 115% e primit, risiguruesi paguan një shumë të barabartë me kapacitetin e plotë të 20% të primit të sigurimit. Ceduesi paguan përparësinë e plotë të 80% dhe një bashkëpagesë prej 6.67% të primit të sigurimit. Shuma e mbetur prej 8.33% e primit të siguruar nuk risigurohet dhe ceduesi përgjigjet për atë shumë.

Risigurimi i tejkalimit katastrofik të humbjes (Catastrophic excess of loss reinsurance)

Ka një klasë të tretë risigurimi proporcional të quajtur risigurimi i tepricës katastrofike së humbjes (Cat – XL). Këtu përveç domosdoshmërisë për të tejkeluar mbajtjen për të pasur mbrojtjen e risigurimit duhet të ketë ndodhur edhe ngjarja katastrofike. Ngjarjet katastrofike mund të jenë, për shembull, një tërmet, një shpërthim që merr të paktën 3 jetë e kështu me radhë.

Risigurimi katastrofik nuk mbulon çdo ngjarje. Përrjashtimet standarde tipike në një marrëveshje të kategorisë XL janë pretendimet që lidhen me incidentet bërthamore ose radioaktive. Edhe terrorizmi është përjashtim i zakonshëm. Për këto risqe dhe risqe të tjera politike, janë krijuar rezerva qeveritare ose të industrisë kombëtare. Rezervat do t'i diskutojmë më vonë.

Përcaktimi i çmimit

Përcaktimi i çmimit të risigurimit jo-proporcional është një aktivitet që zhvillohet nga aktuarët me përvojë. Midis metodave të përdorura për përcaktimin e kostos së risigurimit janë vlerësimi i (burning cost), modelimi me anë skenarësh dhe përcaktimi i çmimit të ekspozimit. Vlerësimi i (burning cost) rezulton nga përvoja e kaluar e pretendimeve mbi mbajtje dhe nën kapacitetin, duke përfshirë rregullimet e bëra për inflacionin, ndryshimet në kushte, etj. Kostoja që rezulton është shuma e nevojshme për të paguar dëmet e pritura ose i ashtuquajturit prim i riskut. Primi i risigurimit pastaj është primi i riskut i ngarkuar me shpenzimet dhe fitimin. Modelimi me anë skenarësh përdor modele matematike që përdorin shpërndarjet e dëmeve për të simuluar ekspozimin e riskut të portofolit të risiguar. Kryhen disa stimulime për të përcaktuar humbjen e mundshme mbi mbajtje dhe nën kapacitetin e traktatit. Përsëri kjo kosto ngarkohet me shpenzimet dhe fitimin për të përcaktuar primin e risigurimit. Përfundimisht, caktimi i çmimit të ekspozimit merr parasysh portofolin ekzistues të risiguar dhe transferon probabilitete empirike për dëmet që do të ndodhin për çdo risk të risiguar që mund të

rezultojë në shuma mbi mbajtjen.

Në risigurimin jo-proporcional, kohëzgjatja tipike e një marrëveshjeje është vjetore, meqenëse ndryshimet në kushtet e tregut, në ekonomi dhe në portofolin e risiguar ndikojnë drejtpërdrejt në kostot e risigurimit. Marrëveshja jo-proporcionale nuk ofron një pjesëmarrje për ndarjen e fitimit që në rastin e risigurimit proporcional përdoret për të kompensuar ceduesin për biznesin e mirë të marrë në sigurim, për shkak të ekspozimit të ndryshëm që ceduesi dhe risiguruesi kanë këtu.

Programet e risigurimit

Risigurimi garanton një mjet fleksibël dhe efektiv për shoqëritë e sigurimeve për menaxhimin e risqeve që ato marrin përsipër. Kombinimi i disa marrëveshjeve të risigurimit quhet programi i risigurimit. Një program risigurimi i strukturuar mirë garanton avantazh të rëndësishëm konkurrues por mund të jetë mjaft kompleks. Disa risigurues mund të marrin pjesë në një program risigurimi duke pranuar përqindje të ndryshme të programit. Kjo strukturë ndonjëherë quhet rezervë risigurimi.

Si shembull i thjeshtë, konsideroni efektin e kombinimit të 50% të pjesëmarrjes në kuota me US\$50 XL US\$20 në rend të ndryshëm. Aty marrin pjesë ceduesi, risiguruesi i përqindjes së kuotës dhe risiguruesi XL në rastin e një pretendimi prej US\$100.

- Në rastin e parë pretendimi është që fillimisht të ndahet 50% midis ceduesit dhe risiguruesit të përqindjes së kuotave. Pastaj mbulimi XL mbron përqindjen e ceduesit në dëme prej US\$50, duke paguar US\$30 mbi US\$20.

- Në rastin e dytë XL paguan US\$50 të dëmit dhe ceduesit i lihet dëmi prej US\$70. Pastaj risiguruesi i përqindjes së kuotave merr

përsipër gjysmën e asaj pagese.

Vijon në numrin tjetër...

Për këtë numër punuan:
E. Shehi, R. Guri, F. Musta,
E. Basha, R. Eltari, E. Kokona

